



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
REKTORATI

Nr. 1859/2 Prot.

Vlorë, më, (1. 11. 2020

Vendim

Nr.21, datë 06. 11. 2020

PËR

MIRATIMIN E PROCEDURËS “APLIKIM ONLINE”, PËR STUDENTËT PËR BURSAT DHE PËRJASHTIMET NGA TARIFAT SIPAS VKM NR.39 DHE 40.

Në zbatim të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” Neni 52 “Funksionet e Administratorit”, Statutit të Universitetit, Vendimeve të Këshillit të Ministrave Nr. 39 dhe Nr. 40, datë 23.01.2019, në mbledhjen online, në datën 06.11.2020, Rektorati

VENDOSI

Përdorimin e aplikimit On-line sipas programit Smart, të instaluar pranë zyrave të studentit, për aplikimet për bursa dhe reduktime/përrjashtime nga tarifa e studimit për studentët që studiojnë pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë.

Kjo procedurë e re:

1. Rrit cilësinë e shërbimit kundrejt studentit në kohë reale dhe i përgjigjet situatës aktuale.
2. Mbron shëndetin e të gjithë aktorëve, duke reduktuar kontaktet e drejtëpërdrejta të studentëve me zyrat e studentit dhe grumbullimet në këto zyra për aplikime.
3. Informacioni merret në kohë reale, në lidhje me numrin e aplikimeve për bursa dhe përrjashtime. Është më e lehtë të bëhet parashikimi i fondeve, për bursa, në vitin buxhetor pasardhës si dhe efekti financiar që mund të ketë në buxhet reduktimi/përrjashtimi nga tarifa e studimit për studentët përfitues.
4. Shmang keqkuptimet që mund të krijohen për afatet e dorëzimit nga studentët dhe ato të pranimit nga zyrat të dokumentacionit, pasi aplikimi i studentit lë gjurmë në sistemin elektronik.
- Dorëzimi i dokumentave origjinale në formatin “Hard Copy” nga studentët, mund të bëhet në një moment të dytë, kur situatës aktuale t’i kthehet normaliteti.

REKTORI
Prof. Dr. Roland ZISI